



Inspektorati Shtetëror i Punës
dhe Shërbimeve Shoqërore



REPUBLIKË SHTETËRORE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

SI TË REDUKTONI
AKSIDENTET
NË VENDIN E PUNËS



FLETË-INFORMUESE

28 Prilli është Dita Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Inspektorati Shtetëror i Punës nxit krijimin e kulturës parandaluese për sigurinë dhe shëndetin në punë. Të gjithë ne, si punonjës, punëdhënës, dhe autoritete përgjegjëse, kemi detyrimin për të garantuar që vendi i punës të jetë një ambient i sigurt dhe i shëndetshëm për të gjithë.


SI TË REDUKTONI AKSIDENTET NË VENDIN E PUNËS

Parandalimi i aksidenteve në vendin e punës është një çështje kritike për të gjithë sektorët e punësimit. Sistemet e monitorimit dhe parandalimi i rreziqeve në burim janë thelbësore për reduktimin e tyre. Dialogu social, partneriteti dhe përfshirja e punëtorëve janë të domosdoshme për të siguruar një ambient pune të sigurtë.




Ndërgjegjësimi dhe informimi.

Fushatat e ndërgjegjësimit, përfshirja në trajnime dhe materialet informuese kanë një impakt të ndjeshëm në sjelljen dhe kujdesin e punonjësve në lidhje me rreziqet në ambientin e tyre të punës. Studimet tregojnë se një ndërgjegjësim i mirë dhe informacion i vazhdueshëm mund të sjellë një reduktim deri në 10% të aksidenteve në punë.



Sistem Monitorimi.

Një sistem monitorimi i fortë është thelbësor për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës pasi ndihmon në identifikimin, vlerësimin e rreziqeve në mënyrë efektive, analizë të thelluar dhe statistika për identifikimin e rreziqeve specifike.




Këshillimi i drejtpërdrejtë me kompanitë.

Një mjet efektiv për të ulur deri në 25% shkallën e aksidenteve në vendin e punës. Inspektorët e Punës kane një rol kyç në këtë drejtim, duke ofruar inspektime këshilluese dhe informuese të cilat ndihmojnë në identifikimin e rreziqeve të mundshme dhe në hartimin e masave parandaluese.



Dialogu social, partneriteti dhe përfshirja e punëtorëve.

Dialogu social ndërmjet punëdhënësve, punëmarrësve, sindikatave dhe shoqatave të punëdhënësve synon të sigurojë një partneritet të ndërgjegjshëm dhe të drejtë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Përfshirja e punëtorëve në këtë dialog është e rëndësishme për të identifikuar rreziqet por edhe për të arritur një konsensus më të gjerë në zbatimin e masave dhe politikave parandaluese.



Përshtatja e masave me mjedisin e ndërmarrjes ose industrisë.

Mjaft e rëndësishme është që masat e parandalimit të janë të përshtatshme për rrethanat e veçanta të mjedisin e punës. Një ndihmë e rëndësishme mund të vijë nga këshillat teknike ose trajnimet për identifikimin e rreziqeve specifike.



VLERËSIMI I RISKUT

Rolet dhe Përgjegjësitë

Ligji i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë ka për qëllim të garantojë Sigurinë dhe mbrojtjen e Shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve, eleminimit të faktorëve që përbënë rrezik për aksident, këshillimit, pjesëmarrjes dhe informimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre. Faktoret kryesore për një ambient pune të sigurt e të shëndetshëm janë:

- Punëmarrësit e informuar dhe të konsultuar;
- Dokumenti i Vlerësimit të Riskut;
- Efektiviteti i Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë;
- Personi përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Mjeku i ndërmarrjes.

Vlerësimi i rrezikut është themelor për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe për të garantuar një ambient pune të sigurt nevojitet një ekzaminim i thelluar në të gjitha aspektet siç janë:

- Identifikimi i rreziqeve të mundshme për Shëndetin dhe Sigurinë në vendin e Punës;
- Vlerësimi i rrezikut për të përcaktuar nivelin e rrezikshmërisë për çdo proces;
- Vendosjen e prioritetit për të adresuar rreziqet më të rëndësishme dhe urgjente;
- Zhvillimin e planeve dhe masave për të kontrolluar dhe zvogëluar rreziqet;
- Rishikimin periodik të vlerësimit të rrezikut për të garantuar efektivitetin e masave.

Kush bën çfarë?

Punëdhënësi kà pér detyrë:

- Të garantojë sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në çdo aspekt që lidhet me punën;
- Të organizojë vlerësimin e rrezikut dhe zbatojnë masat mbrojtëse;
- Të zgjedhë personin(at) pér të kryer vlerësimin e riskut;
- Konsultohet me punonjësit ose përfaqësuesit e tyre në lidhje me organizimin e vlerësimit të rrezikut;
- Të sigurojë që të gjithë punonjësit të jenë të informuar pér çdo rrezik dhe masat mbrojtëse.

Punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë/detyrë që:

- Të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut;
- Paralajmërojnë mbikëqyrësit ose punëdhënësit e tyre pér rreziqet e perceptuara;
- Të informohen pér rreziqet dhe pér masat e nevojshme pér eliminimin ose reduktimin e tyre;
- Të propozojë masa pér të minimizuar rreziqet ose pér të eleminuar rrezikun në burim;
- Të bashkëpunojnë pér t'i mundësuar punëdhënësit të sigurojë një mjedis të sigurt pune.

